

Karaminov dhe Emian: Jeni gati për aktivitete më të mëdha



“Me presidentin Gjergji Rulin dhe sekretarin e përgjithshëm Nikolin Dionisi, Shqipëria i ka të gjitha mundësitë për organizimin dhe të aktiviteteve të tjera më të mëdha ndërkombëtare në vendin e vet. “Receta” jonë për të rinjtë, vraponi sa më shumë”

Mitingu ndërkombëtar i atletikës shqiptare, nën emrin e rekordmenit evropian të kërcimit së gjati, armenit Robert Emian, vazhdon të ketë jehonë të madhe. Dhe pas falënderimit që ka

ardhur klubi i shqiptarëve të Maqedonisë, Studenti i Tetovës, tashmë janë dy personazhe të mëdhenj, të cilët i bëjnë elozhe drejtuesve të Federatës Shqiptare të Atletikës.

Bëhet fjalë, pikësëpari për presidentin e Federatës Ballkanike të Atletikës, Karaminov, që është njëkohësisht dhe drejtuesi i Federatës së Bullgarisë, por dhe “mbretin” e mbrëmjes së 26 majit, Robert Emian.

Të dy kanë vlerësuar jo vetëm pritjen, por dhe mitingun e mbi të gjitha mundësinë e Shqipërisë për të bërë dhe të tjera aktivitete ndërkombëtare, ndërsa në radhë është dhe Maratona e Durrësit 2013. Ja dhe vlerësimet e tyre, të dhëna jo vetëm për gazetatat sportive shqiptare, por dhe për drejtuesit e Federatës Shqiptare të Atletikës.

Karaminov: Shqipëria ka mundësi për më shumë

“Unë e njoh Gjergji Rulin dhe Nikolin Dionisin prej shumë kohësh. Megjithatë shfrytëzova mitingun “Robert Emian” për të ardhur në Shqipëri. Do të doja të falënderoja për zemërsisht për mikpritjen e treguar FSHA-në, drejtuesit e saj. E jo vetëm kaq, por dhe për atë çfarë po bëjnë për këtë sport në Shqipëri”, thotë Karaminov në fillimin e prononcimit të tij për mitingun ndërkombëtar.

Duke vazhduar më tej, Karaminov e ka cilësuar një aktivitet të bukur mitingun e organizuar nga Federata Shqiptare e Atletikës, e cila ka mbledhur shtatë vende ballkanike. “Ne gjithsej – thotë bullgari – jemi 11 anëtarë dhe të jemi gjysma e tyre këtu është më shumë se sa sukses.

Atletika Shqiptare, në mënyrë të qartë është duke u rritur dhe tashmë çdokush e njeh atë në familjen evropiane. Ju keni mundësinë të organizoni kampionate më të fuqishme, sepse ju

organizuar për herë të dytë këtë takim ndërkombëtar. Jo vetëm kaq, por pasi keni bërë dhe Kampionatin Botëror të Vrapimit në Mal, atëherë ju keni mundësi për më shumë.

Ndaj ju nxis të vazhdoni në këtë rrugë, pasi vrapimi në mal është një aktivitet i Atletikës i lidhur ngushtë me Turizmin. Mendoj që për 2014-ën, t’i jepet e drejta Shqipërisë për një Maratonë Ballkanike”, ka thënë Karaminov, duke qenë i gëzuar dhe për pritjen që pati në Durrës nga kryebashkiaku Vangjush Dako, i cili ka premtuar që edhe vitin e ardhshëm do të bëhet Maratona e Durrësit, duke qenë tërësisht ballkanike.

Emian: Ju vlerësoj për gjithçka që bëni

“Jam tejet i prekur dhe i vlerësuar nga organizimi i këtij aktiviteti të mrekullueshëm, të organizuar në emrin tim. Që në fillim dua të falënderoj organizimin e shkëlqyer të Federatës Shqiptare të Atletikës, nën drejtimin e presidentit Gjergji Ruli dhe sekretarit Dionisi. Jam ndier i prekur nga mikpritja e jashtëzakonshme dhe ngrohtësia e përgjithshme, jo vetëm nga drejtuesit e FSHA-së, por dhe të tjerë.

Sidomos Medalja “Nderi i atletikës shqiptare”, apo dhe takimet me Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, sidomos me sekretarin e përgjithshëm, Stavri Bello, teksa mora dhe një vlerësim olimpik, ishin gjithçka për mua”, ka thënë Robert Emian, i cili ka vlerësuar dhe takimin që ka pasur me zëvendësministrin e turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve, Salih Tagani.

“Jo vetëm kaq – thotë armeni – por dhe titulli Nderi i qytetit të Durrësit, i dhënë nga kryebashkiaku Dako, është një tjetër vlerësim për mua”. Emian ka vlerësuar pasionin që ka atletët shqiptar, por dhe drejtuesit e saj, për të bërë mirë gjithçka.

“Ka talente të jashtëzakonshme, ku duhet të vlerësoj Izmir Smajlajn, një atlet i nivelit ndërkombëtar, që më një stërvitje më profesionale behet shumë shpejt lider në këtë disiplinë. Premtoj që bashkë me presidentin Ruli do të bëj gjithçka që këtij atleti t’i afrohet një qendër stërvitore profesionale ndërkombëtare”. Armeni ka vlerësuar dhe Luiza Gegën, ashtu siç ka vlerësuar dhe impenjimin e drejtuesve shqiptar për të bërë mirë gjithçka.

“Unë gjej rastin ta falënderoj atletikën shqiptare, jo vetëm për mitingun nën emrin tim, por dhe për organizimin e Botërorit të Vrapimit në Mal, më 2011-ën, apo dhe mitingun nën emrin e Pietro Meneas. Dhe besoj se ka dhe mundësi për të tjera aktivitete, siç është Maratona Ballkanike më 2014. Edhe një herë faleminderit për gjithçka që bëtë”, ka përfunduar Robert Emian, që i ka dhënë këshillën të rinjve: Vraponi sa më shumë...